

UDHËZIM
Nr. 7, datë 10.3.2026

PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 12, DATË 30.6.2023, TË MINISTRIT TË ARSIMIT DHE SPORTIT, “PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe urdhrit nr. 580, datë 11.11.2025, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit, znj. Armela Baka”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 12, datë 30.6.2023, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar, bëhen shtesat, si më poshtë:

a) Pas shkronjës “d” të pikës 1, të kreut X, shtohen shkronja “dh”, si më poshtë:

“dh) Përjashtimisht për vitin akademik 2025–2026, kandidatët për student me diploma të huaja që regjistrohen në programe të përbashkëta studimi të arsimit të lartë, për të cilët vendi i origjinës ka ndryshuar kriteret e pranimi, kanë të drejtën të aplikojnë për regjistrim deri më datë 31 mars 2026.”.

b) Pas pikës 2, të kreut X, shtohen pikat 2/1 dhe 2/2, si më poshtë:

“2/1 Përjashtimisht për vitin akademik 2025–2026, për kandidatët e regjistruar në një program të përbashkët studimi të arsimit të lartë, për të cilët vendi i origjinës ka ndryshuar kriteret e pranimi dhe që kanë detyrimin për njohjen dhe njehsimin e diplomës së huaj, QSHA-ja përfundon procesin e njohjes dhe njësimit të këtyre diplomave brenda datës 31.5.2026.

2/2 IAL-të përcjellin në QSHA, brenda datës 10 qershor 2026, dokumentet e njohjes dhe të njësimit të diplomave të tyre, të lëshuara nga QSHA-ja.”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimit Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
Armela Baka